

VENDIM
Nr.28, datë 9.4.2008

**PËR REVOKIMIN E LICENCËS SË DEGËS NË TIRANË TË BANKËS SË PARË
TË INVESTIMEVE, TIRANË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të nenit 28, pika 1, shkronja “a”, dhe nenit 107, pika 2, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të rregullores “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të revokojë licencën e degës në Tiranë të Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë për shkak të likuidimit vullnetar të saj.

2. Ngarkohet dega në Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë të dërgojë vendimin e likuidimit vullnetar pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe të botojë këtë vendim në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në të paktën dy gazeta kombëtare.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani